



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 137 Prot.

Tiranë, më datë 25.02.2022

VENDIM
Nr. 47, datë 25.02.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.02.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e Vendimarrjes për projektin “*Ish Arqipeshkvia e Durrësit, Delbnisht*”, monument kulture i kategorisë së II-të, në kuadër të projektit “*Rijetëzimi i siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri*”, me aplikues dhe projektues të licencuar në ndërhyrje në pasuri kulturore personi juridik “*Atelier 4*” sh.p.k. dhe zhvillues “*Zyrat e Unops në Shqipëri*”;
 - a. Projekti duhet të plotësohet me relacion argumentues për ndryshimet nga projekti i miratuar.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

